



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SPORTIT  
MINISTRI

6718  
Nr. .... Prot.

Tiranë, më 11.09.2015

UDHËZIM

Nr. 34, datë 11.09.2015

PËR  
VLERËSIMIN E NXËNËSVE PËR KURRIKULËN ME KOMPETENCA, NË  
ARSIMIN BAZË

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, nenit 48 të ligjit nr. 69, datë 21.06.2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

**U D H Ë Z O J:**

**Neni 1**

**Qëllimi i vlerësimit të nxënësit**

Qëllimi kryesor i vlerësimit është të mbështesë të nxënët dhe përparimin e nxënësit. Ky qëllim përmbushet nga kombinimi i vlerësimit për të nxënë dhe i vlerësimit të të nxënët, duke u mbështetur në Kornizën e Vlerësimit të nxënësit në arsimin parauniversitar miratuar më datë 23.07.2015, nga Ministri i Arsimit dhe Sportit.

**Neni 2**

**Vlerësimi për të nxënë i nxënësit**

Vlerësimi për të nxënë i nxënësit kryhet nëpërmjet:

- a. Vlerësimit të vazhduar;
- b. Vlerësimit me test/detyrë përmbledhëse;
- c. Vlerësimit të portofolit të nxënësit.

### **Neni 3**

#### **Vlerësimi i vazhduar**

1. Vlerësimi i vazhduar për të nxënë është pjesë e mësimdhënies dhe motivon përparimin e nxënësve në të gjitha aspektet e të nxënës, në situata të ndryshme të njohura dhe të panjohura.
2. Vlerësimi i vazhduar bazohet në vëzhgimet dhe gjykimet e mësuesit mbi përgjigjet me gojë ose me shkrim, punët në grup, diskutimet e mësuesit me nxënësit, vetëvlerësimin e nxënësit, vlerësimin e nxënësit nga nxënësi, pjesëmarrjen në aktivitete dhe debatet në klasë, vlerësimin e detyrave të shtëpisë apo të klasës etj.
3. Për vlerësimin e vazhduar, mësuesi mban shënime në evidenca për çdo nxënë, lidhur me arritjen e rezultateve të të nxënës.
4. Mësuesi është i lirë të përshtatë formatin e evidencës (modeli bashkëlidhur), në varësi të specifikave të lëndës. Shënimet në evidencë mund të mbahen me notë, simbole, komente referuar niveleve të arritjes.

### **Neni 4**

#### **Vlerësimi me test/detyrë përmbledhëse**

Vlerësimi me test/detyrë përmbledhëse ka për qëllim të matë nivelin e arritjeve të nxënësit për një grup të caktuar rezultatesh të nxënës, në përfundim të tremujorit. Ky vlerësim e orienton mësuesin për të përmirësuar procesin e të nxënës.

### **Neni 5**

#### **Vlerësimi me portofol**

1. Vlerësimi i nxënësit bazuar në portofol ka për qëllim vëzhgimin dhe vlerësimin e nxënësit në një kontekst të gjerë, duke përfshirë dokumentimin e kontributeve dhe arritjeve të tij për fushën, lëndën, për kompetencat kyçe, për punën individuale dhe në grup, krijimtarinë, talentin, si dhe për aspekte të gjykimit dhe reflektimit të nxënësit për veten dhe të tjerët.
2. Portofoli i nxënësit përmban:
  - a. punë dhe detyra të pavarura, të kryera në klasë dhe jashtë saj;
  - b. projekte individuale ose në grup;
  - c. detyra dhe kontribute të nxënësit, të cilat janë dëshmi e talentit, e hulumtimeve praktike, e punëve tematike (me shkrim, audio-vizuale etj.);
  - d. vetëvlerësimet e nxënësit;
  - e. reflektime të prindit ndaj ecurisë së fëmijës.

## Neni 6

### Vlerësimi i të nxënimit të nxënësit

Vlerësimi i të nxënimit të nxënësit kryhet nëpërmjet:

- a. Vlerësimin periodik;
- b. Vlerësimin përfundimtar.

## Neni 7

### Vlerësimi i nxënësimit në klasat I - III

Vlerësimi i nxënësimit në klasat I-III bëhet me përshkrim. Ai përbëhet nga vlerësimi i vazhduar, vlerësimi i punimeve dhe i produkteve si dhe vlerësimi i testimave dhe detyrave të kontrollit.

1. Vlerësimi i nxënësimit për arritjen e kompetencave të fushave të të nxënimit realizohet me përshkrim në periudha periodike tremujore. Ai realizohet me 5 shkallë vlerësimi si më poshtë:
  - a. *Shkalla 1. "Arritje të pakënaqshme"*, kur nxënësi nuk përmbush kërkesat bazë të të nxënimit.
  - b. *Shkalla 2. "Arritje që kanë nevojë për përmirësim"*, kur nxënësi ka arritur vetëm pak nga kërkesat bazë të të nxënimit dhe kërkohet mbështetje dhe punë e vazhdueshme nga ana e tij dhe e mësuesit.
  - c. *Shkalla 3. "Arritje të kënaqshme"*, kur nxënësi ka përmbushur kërkesat bazë të të nxënimit dhe, kur me mbështetjen e mësuesit, arrin të përparojë.
  - d. *Shkalla 4. "Arritje shumë të kënaqshme"*, kur nxënësi ka përmbushur pjesën më të madhe të kërkesave të të nxënimit.
  - e. *Shkalla 5. "Arritje të shkëlqyera"*, kur nxënësi përmbush plotësisht dhe me cilësi kërkesat e të nxënimit të programit lëndor.
2. Vlerësimi përfundimtar kryhet sipas ndarjes më poshtë:
  - a. Vlerësimi i vazhduar, përbën 45 %, të vlerësimin përfundimtar. Ky vlerësim mbështetet në përgatitjen e nxënësimit dhe detyrat që ai bën në shtëpi (15%), si dhe në punët me shkrim që kryen nxënësi në klasë dhe përgjigjet që jep me gojë (30%).
  - b. Vlerësimi i punimeve dhe i produkteve përbën 25% të vlerësimin përfundimtar dhe vlerëson punën e pavarur, bashkëpunimin me nxënësimit e tjerë, pjesëmarrjen në projekte dhe veprimtari të tjera që zhvillohen në klasë, si dhe nismat e tij individuale.
  - c. Vlerësimi i rezultateve në teste dhe në detyra kontrolli përbën 30% të vlerësimin përfundimtar.
3. Në fund të vitit, pas realizimit të vlerësimin të tretë përshkrues, mësuesi përmbledh përparimin vjetor të nxënësimit për kompetencat e fushave të të nxënimit.
4. Vlerësimi përfundimtar i nxënësimit për secilën lëndë, bëhet në fund të vitit shkollor.

## Neni 8 Vlerësimi periodik për klasat IV - IX

1. Vlerësimi periodik kryhet në fund të një periudhe tremujore, për të evidentuar përparimin dhe arritjet e nxënësve me qëllim monitorimin dhe raportimin e tyre.
2. Vlerësimi periodik tremujor jepet nëpërmjet 3 (tre) notave të veçanta për:
  - a. Vlerësimin e vazhduar me notë, që përmbledh shënimet e mësuesit të mbajtura në evidencat për periudhën tremujore.
  - b. Vlerësimin me notë nëpërmjet testit ose detyrës përmbledhëse në përfundim të periudhës tremujore.
  - c. Vlerësimin me notë të portofolit të nxënësit për periudhën tremujore.
3. Këto vlerësime me notë shënohen në regjistër në kolonat përkatëse në përfundim të çdo tremujori.

## Neni 9 Vlerësimi përfundimtar për klasat IV - IX

1. Vlerësimi përfundimtar kryhet në përfundim të vitit shkollor me notë dhe me përshkrim referuar niveleve të arritjes.
2. Nota përfundimtare përfshin notat vjetore si më poshtë:
  - a. Notën vjetore të vlerësimit të vazhduar për tri periudha tremujore.
  - b. Notën vjetore të vlerësimit me test/detyrë përmbledhëse për tri periudha tremujore.
  - c. Notën vjetore të vlerësimit të portofolit të nxënësit për tri periudha tremujore.
3. Peshat në përqindje sipas vlerësimeve:

	Pesha në përqindje Klasa IV - V	Pesha në përqindje Klasa VI - IX
Vlerësimi i vazhduar	45%	40%
Vlerësimi me test/detyrë përmbledhëse	30%	40%
Vlerësimi i portofolit të nxënësit	25%	20%

4. Hapat për njehsimin e notës përfundimtare janë:
  - a. Përcaktohet nota vjetore e vlerësimit të vazhduar ( $NV_V$ ).
  - b. Përcaktohet nota vjetore e testit/detyrës përmbledhëse ( $NT_P$ ).
  - c. Përcaktohet nota vjetore e portofolit të nxënësit ( $NV_P$ ).
  - d. Shumëzohet secila prej notave me përqindjen përkatëse.
  - e. Mblidhen këto prodhime dhe shuma rrumbullakoset me numër të plotë (psh.  $8,8 \approx 9$ ).
  - f. Formula (klasa IV - V): Nota përfundimtare =  $(NV_V \times 0.45) + (NT_P \times 0.3) + (NV_P \times 0.25)$ .
  - g. Formula (klasa VI - IX): Nota përfundimtare =  $(NV_V \times 0.4) + (NT_P \times 0.4) + (NV_P \times 0.2)$ .

5. Përshkrimi i notës përfundimtare argumenton nivelin e arritjeve të kompetencave të fushës/lëndës.

**Neni 10**  
**Raportimi i arritjeve dhe përparimit të nxënësve**

1. Raportimi i arritjeve të të nxënësve bëhet nga mësuesi një herë në tre muaj dhe i jepet me shkrim prindit.
2. Raportimi i arritjeve dhe përparimit të nxënësve ka dy qëllime kryesore:
  - a. Së pari siguron informacion të plotë dhe të vazhdueshëm rreth të nxënësve të nxënësve dhe përparimit të tyre, duke shërbyer si bazë për të krahasuar arritjet me rezultatet e pritshme të të nxënësve.
  - b. Së dyti krijon një platformë, e cila u shërben mësuesve dhe prindërve të mbështesin nxënësit në hapat e mëtejshëm të të nxënësve, si dhe vetë nxënësve të zhvillohen në këtë proces.
3. Raportimi i arritjeve dhe përparimit të nxënësve bazohet në evidencat e vlerësimit të vazhduar, testet/detyrat përmbljedhëse si dhe portofoli i nxënësit.

**Neni 11**  
**Dispozita të fundit**

1. Evidencat, testet/detyrat përmbljedhëse dhe portofoli i nxënësit ruhen në shkollë për një vit shkollor dhe janë objekt monitorimi.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij Udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Arsimit Parauniversitar në MAS, Instituti i Zhvillimit të Arsimit, Agjencia Kombëtare e Provimeve, Inspektorati Shtetëror i Arsimit, njësitë arsimore vendore (Drejtoritë Arsimore Rajonale/Zyrat Arsimore) dhe shkollat.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren Zyrtare".

LINDITA NIKOLLA  
  
MINISTËR



EVIDENCA TREMUJORE PËR VLERËSIMET E NXËNËNSVE PËR KURRIKULËN ME KOMPETENCA NË ARSIMIN BAZË

KLASA VI-

TREMUJORI .....

Nr	Emri Mbiemër	Muajt/Datat:												Komente
1														..... .....
2														
3														
4														
5														

Shënim: Ky format llogaritet në A3, si rrjedhim numri i nxënësve është më i madh. Një lëndë mund të ketë një ose dy fletë (nga të dyja faqet). Në varësi të lëndës mund të llogaritet edhe numri i vlerësimeve. Kolona e komenteve në faqe A3 duhet të jetë më e gjatë.